



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.235, datë 16.09.2022

PËR
“CAKTIMIN E ZOTIT KLEANTH ZEKA NË GJYKIMIN E ÇËSHTJES
KUNDËR TË PANDEHURIT MIHAL THIMJO”

Bazuar në pikën 1 të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 15, pika 1 dhe nenin 170/1 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë **zotin Kleanth Zeka**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për përfaqësimin e akuzës në çështjen në gjykim kundër shtetasit Mihal Thimjo, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.
2. Zoti Zeka do të përfitojë kompensim financiar sipas parashikimeve të pikës 1, neni 15 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Kleanth Zeka, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 16.09.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurrihan Seiti

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani